



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

UDHËZUES

**“MBI MËNYRAT DHE FORMAT E MENAXHIMIT TË QËNDRUESHËM
FINANCIAR TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”**

Tiranë, 2025



TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	3
1.BAZA LIGJORE.....	3
2.PËRKUFIZIMI I QËNDRUESHMËRISË FINANCIARE	3
3.OBJEKTIVAT E UDHËZUESIT	4
4.INDIKATORËT E VLERËSIMIT TË QËNDRUESHMËRISË FINANCIARE.....	4
Tabela 1: Indikatorët e Qëndrueshmërisë.....	4
5.Klasifikimi i IAL-ve sipas Qëndrueshmërisë.....	5
6.MODELET E TABELAVE DHE PERFORMANCA FINANCIARE	5
Tabela 2: Menaxhimi financiar (40 pikë).....	5
Tabela 3: Shpërndarja e të ardhurave (20 pikë).....	5
Tabela 4: Eficenca e shpenzimeve (20 pikë).....	5
Tabela 5: Bilanci buxhetor (10 pikë).....	6
Tabela 6: Raporti me performancën akademike (10 pikë).....	6
7.Procedura e Raportimit dhe Monitorimit.....	6
8.Monitorimi i Riskut Financiar	6
Tabela 7: Regjistri i riskut	7
9.Mekanizmi i Rekomandimit.....	7
10.Përfundime	7



HYRJE

Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) ka hartuar këtë udhëzues si një manual praktik për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL). Qëllimi është t'i ndihmojë ato të matin dhe raportojnë qëndrueshmërinë financiare dhe riskun financiar në përputhje me ligjin. Ky udhëzues është i thjeshtuar, me tabela standarde dhe shembuj praktikë, për të lehtësuar procesin e raportimit.

1. BAZA LIGJORE

Udhëzuesi mbi qëndrueshmërinë financiare të institucioneve të arsimit të lartë mbështetet në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, si më poshtë:

- Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
 - IAL-të përdorin këtë ligj për të identifikuar dhe raportuar riskun financiar.
 - AKFAL analizon regjistrin e riskut dhe i raporton MAS dhe Bordit Drejtues për masat korrigjuese.
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.
 - IAL-të përdorin këtë ligj për të raportuar të ardhurat dhe shpenzimet sipas klasifikimeve buxhetore.
 - AKFAL monitoron respektimin e disiplinës buxhetore dhe përdorimit të fondeve publike.
- VKM nr. 397, datë 03.05.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)”.
- Rregulloren e Brendshme të AKFAL, miratuar me Urdhërin Nr. 19, datë 13.01.2023.
- Udhëzimet e përbashkëta të Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave, të cilat konkretizojnë procedurat për menaxhimin, raportimin dhe përdorimin e fondeve publike, si dhe grantet e mësimdhënies dhe të zhvillimit.

2. PËRKUFIZIMI I QËNDRUESHMËRISË FINANCIARE

Qëndrueshmëria financiare është aftësia e një institucioni publik të arsimit të lartë për të siguruar, menaxhuar dhe përdorur burimet e tij financiare në mënyrë të tillë, që të garantojë mbulimin e shpenzimeve bazë, të zhvillimit dhe kërkimit shkencor, pa cënuar funksionimin e institucioneve publike të arsimit të lartë.

Qëndrueshmëria financiare lidhet me kapacitetin për të siguruar dhe për të shpërndarë burimet e të ardhurave, për të ruajtur balancën mes të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe për të krijuar rezerva që e mbrojnë institucionin nga risqe të mundshme. Ajo lidhet gjithashtu me

raportin ndaj rezultateve akademike, duke vlerësuar se si burimet financiare mbështesin numrin e studentëve të diplomuar, programet e ofruara dhe arritjen e objektivave institucionale në përputhje me misionin universitar.

3. OBJEKTIVAT E UDHËZUESIT

Ky udhëzues:

- Krijon një metodologji të qartë dhe orientuese për matjen dhe monitorimin e qëndrueshmërisë financiare të IAL-ve publike.
- Mundëson krahasueshmërinë ndërmjet IAL-ve publike mbi bazën e të dhënave financiare.
- Ofron AKFAL-it një instrument praktik për monitorim dhe mbështetje analitike të qëndrueshmërisë financiare së IAL-ve publike.
- Orienton institucionet publike të arsimit të lartë drejt menaxhimit më eficient dhe shumëllojshmërisë së burimeve financiare.
- Shërben si bazë për hartimin e politikave të reja financiare në arsimin e lartë.

4. INDIKATORËT E VLERËSIMIT TË QËNDRUESHMËRISË FINANCIARE

Tabela 1: Indikatorët e Qëndrueshmërisë

Indikatori	Pesha (pikë max)	% e realizimit	Pikët (Pesha x % e realizimit)
Menaxhimi financiar	40		
Shpërndarja e të ardhurave	20		
Eficienta e shpenzimeve	20		
Bilanci buxhetor	10		
Raporti me performancën akademike	10		
Totali	100		

Hapat:

1. Fillimisht, merren të dhënat reale financiare dhe akademike të universitetit.
2. Pastaj krahasohen me kufijtë standardë. (sipas tabelave në pikën 6)
3. Jepet përqindja e realizimit (%).
4. Përqindja shumëzohet me peshën (40, 20, 20, 10, 10) → dalin pikët.
5. Pikët mbledhen për të dhënë rezultatin total (0–100).

5. Klasifikimi i IAL-ve sipas Qëndrueshmërisë

Në bazë të rezultateve të vlerësimit, institucionet publike të arsimit të lartë klasifikohen si më poshtë:

- Me qëndrueshmëri të lartë (75 - 100 pikë)
- Me qëndrueshmëri mesatare (50 - 74.9 pikë)
- Me qëndrueshmëri të ulët (nën 50 pikë)

6. MODELET E TABELAVE DHE PERFORMANCA FINANCIARE

Për të lehtësuar procesin e raportimit dhe krahasimit të qëndrueshmërisë financiare ndërmjet IAL-ve, AKFAL mbështetet mbi të dhënat e vlerësimit financiar të standardizuar.

Më poshtë paraqiten formatet orientuese:

Tabela 2: Menaxhimi financiar (40 pikë)

Treguesit	% e realizimit	Pikë (maks. 40)
Likuiditet i mirë, pagesa në kohë, risk i ulët, suficit i lehtë	75-100%	30-40
Likuiditet mesatar, disa vonesa, risk i moderuar	50-74%	20-29
Probleme serioze likuiditeti, deficit i përsëritur	20-49%	8-19
Deficit i madh, risk i lartë, paaftësi pagesash	0-19%	0-7

Tabela 3: Struktura e të ardhurave (20 pikë)

Treguesit	% e realizimit	Pikë (maks. 20)
Burimi i vetëm buxhet shteti	0-20%	0-4
Buxhet + tarifa studentore	40-50%	8-10
Buxhet + tarifa + projekte/donacione	70-80%	14-16
Më shumë se 50% të ardhura jo-buxhetore	100%	20

Tabela 4: Eficenca e shpenzimeve (20 pikë)

Treguesit	% e realizimit	Pikë (maks. 20)
Paga ≤ 65% e totalit, strukturë efikase	90-100%	18-20
Paga 65-75% e totalit	70-80%	14-16
Paga mbi 75-80%	40-60%	8-12
Paga mbi 80% e totalit, shpenzime joefikase	<40%	0-7

Tabela 5: Bilanci buxhetor (10 pikë)

Treguesit	% e realizimit	Pikë (maks. 10)
Suficit financiar	100%	10
Buxhet në ekuilibër (0)	70%	7
Deficit i vogël	40–50%	4–5
Deficit i madh	0–20%	0–2

Tabela 6: Raporti me performancën akademike (10 pikë)

Treguesit	% e realizimit	Pikë (maks. 10)
Kosto/student brenda kufijve optimalë + raport staf/student i balancuar	90–100%	9–10
Disa devijime nga kufijtë optimalë	50–70%	5–7
Joefikasitet i dukshëm (kosto shumë e lartë ose raport staf/student i paekuilibruar)	<40%	0–4

7. Procedura e Raportimit dhe Monitorimit

Bashkëngjitur raportit financiar vjetor, IAL-të dorëzojnë edhe vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare, plotësuar mbi bazën e indikatorëve të këtij udhëzuesi.

AKFAL kryen analizën krahasuese të vlerësimit të qëndrueshmërisë financiare për secilin institucion dhe harton një raport përfundimtar për Bordin Drejtues. Në bazë të këtij raporti, AKFAL realizon shpërndarjen e fondeve dhe rekomandon masat për përmirësimin e menaxhimit financiar në IAL.

8. Monitorimi i Riskut Financiar

IAL-të do të plotësojnë një regjistër të riskut, i cili për secilin element do të përcaktojë:

- Probabilitetin e shfaqjes së riskut (*i ulët, mesatar, i lartë*).
- Ndikimin në qëndrueshmëri (*i ulët, mesatar, i lartë*).
- Mënyra e menaxhimit (*parandalim, diversifikim, ristrukturim*).

Tabela 7: Regjistri i riskut

Risku i identifikuar	Probabiliteti (Lartë/ Mesatar/Ulët)	Ndikimi (Lartë/ Mesatar/Ulët)	Mënyra e Menaxhimit
Rënia e numrit të studentëve			
Varësia nga buxheti i shtetit			
Shpenzime joefikase			
Projekte të papërfunduara			
Kontroll i dobët i brendshëm			

9. Mekanizmi i Rekomandimit

Në bazë të vleresimit financiar, IAL-të klasifikohen në tri kategori:

- Institucione me qëndrueshmëri të lartë;
- Institucione me qëndrueshmëri mesatare;
- Institucione me qëndrueshmëri të ulët.

10. Përfundime

Ky udhëzues synon të shërbejë si dokument orientues për të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, duke garantuar një proces të unifikuar, transparent dhe krahasues për matjen e qëndrueshmërisë financiare. Duke ndjekur këto udhëzime, IAL-të sigurojnë përputhje me ligjin, transparencë financiare dhe qëndrueshmëri afatgjatë.